REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3998 Prot. Maliq, më 26.06.2026

VENDIM
Nr.81, datë 25.06.2026

"PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR VENIEN NË DISPOZICION TË TRUALLIT PËR NDËRTIMIN E ZYRËS SË MARRËDHËNIEVE ME KONSUMATORËT NGA UJËSJELLËS KANALIZIME"

Në mbështetje" të ligjit nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1.2 gërma b dhe c, nenit 23, nenin 55 *"Votimi"*pika 2 dhe 6 neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*" gërma "c", kërkesës nr.710 prot, datë 01.06.2026, të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë Sh.a, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Për fillimin e procedurave për venien në dispozicion të truallit për ndërtimin e Zyrës së Marrëdhënieve me Konsumatorët nga Ujësjellës-Kanalizime sipas planvendosjes dhe planit të rilevimit bashkëngjitur këtij projekt-vendimi.
   - Pasuria nr.3/590, e ndodhur në Zonën Kadastrale 2573, me sipërfaqe 510 m^2.

2. Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve, të kryeje verifikimet e dokumentacionit ligjor (statusit juridik) pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të pasurisë që preken nga zbatimi i projektit, si dhe të vijojë procedurat e metejshme të përgatitjes së dokumentacionit të plotë që nevojitet.

3. Për zbatim ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq.

   Miratuar me 21 vota
   Vota Pro 21
   Vota Kundër 0
   Vota Abstenim 0
   Zbardhur me datë 26.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ